



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Përgjithshëm**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**                      **Prot.**  
**Nr. Dok. 201701598/2**

**Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2017

**Lënda:**            *Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve Kavajë.*

**Drejtuar:**        **Z. Isa SAKJA**  
**Kryetar i Bashkisë**

**KAVAJË**

**Znj.Luneda SUFALI**  
**Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimit**  
**Social Shtetëror**

**TIRANË**

**Për dijeni:**      **Z. Fisnik KRASNIQI**  
**Drejtor i të Shtëpisë së të Moshuarve**

**KAVAJË**

Avokati i Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut, më datë 24.11.2017, ka vijuar inspektimin në Shtëpinë e të Moshuarve, Kavajë.

Ky inspektim u krye në mbështetje të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku parashikohet ndër të tjera se: "Avokati i Popullit ose persona të autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim apo autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në azile dhe vecanerisht në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër ku ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut".

"Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund

*të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise”.*

Qëllimi i inspektimit ishte zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në vitin 2016 si dhe vijimi i inspektimit.

Ju bëjmë më dije se më datë 23.09.2016, është kryer inspektimi në Shtëpinë e të Moshuarve Kavajë. Pas problemeve të konstatuara, i rekomanduam Kryetarit të Bashkisë Kavajë dhe Shërbimit Social Shtetëror marrjen e masave për:

1. Hidroizolimim e tarracës.
2. Rritjen e numrin të stafit me: roje objekti, psiqiatër, mjek me kohë të plotë, mjek dentar me kohë të pjesshme.
3. Funksionimin e sistemit të ngrohjes.
4. Zëvendësimi i pllakave të dushit me të reja.
5. Miratimin e Rregullores se Brendshme të Shtëpisë së të Moshuarve Kavajë.
6. Trajnimi i stafit për përdorimin e mjeteve kundër zjarreve.
7. Monitorimi i evidencave të përfituesve të qendrës për planifikimin e fondeve.

Në përgjigje të rekomandimeve të sipërcituara, nga ana e Shërbimit Social Shtetëror informohemi si më poshtë:

- Për rekomandimin nr.2, *për rritjen e numrin të stafit me: roje objekti, psiqiatër, mjek me kohë të plotë, mjek dentar me kohë të pjesshme*, organika e kësaj qendre është miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr.43 datë 17.08.2016. Organika e këtij institucioni është plotësuar me një psikolog dhe kujdestar dhe mjek me kohë të pjesshme. Për nevojat që ka institucioni, Bashkia Kavajë ka tagrin ligjor për të plotësuar me fondet e saj strukturën e institucionit dhe vet institucioni vepron për të patur roje objekti.
- Për rekomandimin nr.6, *trajnimi i stafit për përdorimin e mjeteve kundër zjarreve*, jano planifikuar dhe realizuar nëpërmjet zjarrfikseve trainimi i stafeve të Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror mbi përdorimin e mjeteve kundër zjarrit.
- Për rekomandimin nr.7, *monitorimi i evidencave të përfituesve të qendrës për planifikimin e fondeve*, numri i përfituesve të qendrës pasqyrohet në kërkesat që bën vet institucioni për fonde.

Ndërsa Bashkia Kavajë, na informon si më poshtë:

- Bashkia Kavajë ka parashikuar një fond të veçantë në buxhetin e saj për kryerjen e punimeve për përmirësimin e gjendjes në Shtëpinë e të Moshuarve Kavajë për hidroizolimim e tarracës dhe në muajin Shkurt 2017 i është kërkuar Ministrisë së Financave akordimi sa më parë i këtij fondi. Është përfunduar projekti për hidroizolimim e tarracës.

Në takimin e bërë me Drejtuesin e institucionit dhe me punonjësen sociale, konstatuam se rekomandimi:

1. *Për hidroizolimim e tarracës* është realizuar. Punimet ishin kryer gjatë periudhës Tetor - Nëntor 2017.
2. *Për rritjen e numrin të stafit me: roje objekti, psiqiatër, mjek me kohë të pjesshme, mjek dentar me kohë të pjesshme*, nuk është realizuar.
3. *Për funksionimin e sistemit të ngrohjes*, është realizuar.

4. *Për zëvendësimi i pllakave të dushit me të reja.* Aktualisht është lëvruar fondi dhe janë në pritje të përfundimit të procedurave për fillimin e punimeve.
5. *Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Shtëpisë së të Moshuarve Kavajë.* Rregullorja ishte hartuar nga Drejtuesi i Shtëpisë së të Moshuarve Kavajë dhe do dërgohej në Bashkinë Kavajë për t'u miratuar nga Këshilli Bashkiak.
6. *Për trajnimin e stafit lidhur me përdorimin e mjeteve kundër zjarreve,* është realizuar pjesërisht, pasi është trajnuar vetëm një pjesë e stafit.
7. *Për monitorimi i evidencave të përfituesve të qendrës për planifikimin e fondeve,* nuk është realizuar.

Nga inspektimi i kryer rezultoi si më poshtë:

Në këtë Shtëpi të Moshuarish trajtohen të moshuar mbi 60 vjeç, por edhe nën këtë moshë si dhe të moshuar me probleme të rënda shëndetësore. Kapaciteti i përfituesve është 65 persona. Aktualisht strehohen 49 të moshuar. Gjithashtu që nga muaji Tetor 2016, për efekt të rikonstruksionit të Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër, janë transferuar përkohësisht dy të moshuar.

Përfitues të pensionit të pleqërisë ishin 39 të moshuar dhe 10 përfitues të ndihmës ekonomike, të cilët nuk paraqitën ankesa ndaj stafit për këtë shërbim.

Personeli i kësaj qendre përbëhet nga 23 punonjës, të cilët kishin dosjet e tyre personale me kualifikimet përkatëse. Përshkrimi i punës së tyre ishte i përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të institucionit. Bëhej vlerësimi i punës për personelin, i cili ka filluar të aplikohet që në vitin 2016.

Shërbimi mjekësor realizohej nga një mjek me kohë të pjesshme dhe infermieret. Lidhur me vizitat e nevojshme mjekësore, ato përcaktohen nga mjeku, i cili i adreson tek mjeku specialist. Për ata të moshuar, të cilët paraqesin probleme shëndetësore, transportimi për në spital bëhej nga vetë Drejtori. Ka rezultuar bashkëpunuese edhe Urgjenca Kavajë që sa herë i është kërkuar ndihmë, ajo është përgjigjur në kohë.

Vizitat dentare bëhen individualisht, me shpenzimet e tyre dhe jo me fondet e institucionit.

Plani individual për çdo të moshuar mbahej në zyrën e infermiereve.

Kuota ushqimore ditore për çdo të moshuar është 300 lekë. Kampionët e ushqimeve ruheshin në frigorifer. Merret mendimi i përfituesve për përcaktimin e menisë së ushqimit dhe vakteve të ngrënies. Dieta ushqimore përcaktohet me rekomandim të mjekut dhe i bashkangjitet menisë së ushqimit.

Të gjithë artikujt hotelorikë të vjetra e të dalë jashtë përdorimit, si dyshekë, jastekë etj, do të zëvendësohen me të reja. Pritej furnizimi i 20-30 dyshekëve, 20-30 tavolinave për ata të moshuar, të cilët janë të pamundur për të shkuar në muncë, peshqirë, bizhame etj, të mundësuar nga Banka "Societe Generale Albania".

Organizata angleze "Contact Albania", ka veshur korridorin e katit të parë me pllaka të bardha.

Organizata austriake "Diakon Albania" i furnizon me ilaçe e enë të kuzhinës.

Ishte lyer dera kryesore, e cila i kishte dhënë një pamje tjetër hyrjes në këtë institucion.

Në çdo dhomë kishte televizor.

Ishte krijuar një dhomë për mbajtjen e riteve të fundit të jetës.

Me qëllim mbajtjen në kushte sa më të mira të produkteve ushqimore, ishin porositur raftet për t'u vendosur në magazinë.

Në ambiente të veçanta ishin vendosur standartet që duhet të respektonin punonjësit e qendrës.

Kutia e ankesave hapet një herë në muaj. Çelësi i saj mbahej nga një punonjës i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Kavajë.

Mjetet për shmangjen e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, ishin të vendosura në një kënd të caktuar. Nuk është trajnuar i gjithë stafi për përdorimin e fiskeve të zjarrit

Sistemi i ngrohjes dhe ftohjes realizohet me ngrohëse me korent. Në çdo dhomë kishte nga një ngrohëse.

Organizoheshin aktivitete të ndryshme, festat fetare, festat zyrtare, ditëlindje, etj. Të moshuarit ndjekin ritet fetare. Vijnë shumë shkolla arsimore publike për të zhvilluar aktivitete të ndryshme.

Nga vetë Drejtuesi organizohej pirja e kafesë me të moshuarit në ambiente jashtë qendrës.

Në kuadrin e shkëmbimit të eksperiencave, janë zhvilluar bashkëpunime ndëristitucionale të Qendrave të Përkujdesit Social, konkretisht me Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastër dhe Poliçan.

Monitorimi i standarteve kryhet nga Bashkia Kavajë, Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria e Higjienës në Kavajë, etj.

Nga takimi me të moshuarit e qendrës, ata shprehën konsideratën ndaj Drejtuesit të institucionit dhe nuk paraqitën ankesa ndaj stafit.

Vlen për të theksuar faktin e një përkushtimi dhe vizioni në punë i drejtuesit të kësaj Shtëpie të Moshuarish, i cili kishte vetëm shumë pak muaj që ishte emëruar dhe gjatë kësaj periudhe ishin bërë të mundura realizimi i disa prej rekomandimeve tona.

Më datë 23 tetor 2017, ky institucion është vizituar një grup drejtuesesh dhe aktiviste të shoqatave, të cilat janë në mbrojtje të të drejtave të grave dhe të të moshuarve. Pas zhvillimit të aktivitetit, ato kanë shprehur konsideratat e tyre në Librin e Përshtypjeve të këtij institucioni.

Gjatë këtij inspektimi, u konstatuan problematikat e mëposhtme:

1. Nuk ka psikiatër, i domosdoshëm për të moshuarit.
2. Meqë të moshuarit kanë shumë probleme shëndetësore, duhet që të jetë prezent mjeku me kohë të plotë si dhe një dentist me part-time.
3. Kuota ditore ushqimore për çdo të moshuar në vlerën e 300 lekëve, sipas Drejtuesit të këtij institucioni, nuk është e mjaftueshme. Pavarësisht se fitohet nga tenderimi ai që ofron me çmimin më të ulët, cilësia nuk është e mirë. Aktualisht, me rritjen e çmimeve të mallrave ushqimore, kërkohet rritje e vlerës së kuotës ditore, nga 300 lekë në 350 lekë në muaj.
4. Një problematikë që haset jo vetë në këtë institucion, por në të gjitha qendrat e përkujdesjes sociale, është çështja e shërbimit dentar. Ky shërbim mbulohet nga vetë të moshuarit. Do të sugjerohet që të një pjesë e këtij shërbimi të rimburohet nga shteti.
5. Në këtë institucion, strehohen të moshuar, të cilët janë me probleme të rënda shëndetësor, gjë që bëhet pengesë për një jetesë normale të të moshuarve.

6. Një problem shqetësues që ende ka mbetur pa zgjidhje, është mungesa e makinës, e shoferit.
7. Nuk ka roje objekti. Aktualisht dera vetëm mbyllet me dryn dhe monitorimi bëhet nga stafi dhe kamerat e sigurisë.
8. Lidhur me masën e mbajtjes së pensionit të pleqërisë, 40%. Tre të moshuar, të cilët janë përfitues të pensionit të pleqërisë, e kanë masën e pensioni të pleqërisë shumë të ulët. Nga mbajtja e shumës prej 40 % të saj, atyre u mbeten për përdorim një shumë lekësh më pak se ato të moshuar, të cilët marrin 6000 lekë në muaj si ndihmë.
9. Vendi mbi të cilin është ndërtuar Shtëpia e të Moshuarve Kavajë, është me probleme permanente lagështire, gjë që ndikon drejtpërsëdrejti në shëndetin e të gjithë personave që strehohen në këtë institucion dhe jo vetëm. Prezenca e lagështirës kërkon gjithmonë ristrukturim të ambjenteve të godinës edhe pas përfundimit të saj, pasi nuk mjafton vetëm lyerja. Kjo do të ndikonte edhe në buxhet, në një kohë që ai fond mund të përdoret për zëra të tjera.

Sa më lart, për të plotësuar standartet e përkujdesit shoqëror për të moshuarit, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*,

## **REKOMANDOJMË**

1. Shtim në organikë me: roje objekti, psikiatër, mjek me kohë të plotë.
2. Vendosjen e një automjeti.
3. Shtim në buxhet lidhur me mirëmbajtjen e objektit ose të shihet mundësia për transferim në një godinë tjetër të përshtatshme.
4. Trajnimi i të gjithë stafit për përdorimin e mjeteve kundër zjarreve.
5. Ngritjen e një grupi pune për të grumbulluar të gjithë personat me probleme të rënda shëndetësore në një qendër zhvillimi.
6. Rritjen e kuotës ushqimore ditore, minimalisht në 350 lekë.
7. Pas verifikimeve përkatëse, të shihet mundësia për gjetjen e një zgjidhje për të arritur në kuotën e 6000 lekëve në muaj për ata të moshuar, të cilët kanë masa të ulëta të pensioneve të pleqërisë.

*Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se,*

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

*Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.*

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

**K O M I S I O N E R I**

**Ermir KAPEDANI**